

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e katërt, deri më 28.01.2024)**

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së katërt të vitit 2024 (nga 22-28.01.2024), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **1.834 (I=99,9/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 9,5% më shumë krahasuar me javën e kaluar (n=1.675).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar (n=874) është regjistruar një rritje prej 2,1 herë, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=1.714) është regjistruar një rritje prej 7,0%. (*Grafiku 1*)

Gjatë javës së katërt të vitit 2024, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 67 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara edhe për grip edhe për COVID-19. 20 raste kanë rezultuar pozitive për Influenza, 14 Influenza A(H1)pdm09, 2 Influenza A(H3) dhe 3 Influenza A - e pasubtipizuar dhe 1 Influenza B – linjë e papërcaktuar. Është regjistruar 1 rast me COVID-19.

Incidenca e raportuar është mbi kufirin favor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000) (*Grafiku 1*).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja favore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 982 persona, nga 0-4 vjet – 342, tek grupmosha nga 5-14 – 256 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 254 persona. Incidencë më e lartë (354,3/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë raportuar nga 27 QShP/NjR: Shkup – 238, Manastir – 196, Kavadar - 184, ndërsa në të tjerat numri i rasteve të raportuara është më pak se 150.

Nga njësitë e raportimit që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave në 8 është regjistruar aktivitet sezonal i virusit të gripit, në 12 mesatar, ndërsa në 1 i lartë dhe në 3 shumë i lartë (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e katërt 2024



Gjatë kësaj jave janë regjistruar 2 raste të vdekjes nga gripi, persona në moshë 20 dhe 36 vjet nga Shkupi dhe Demir Hisari, të shtruar në KSIGjF, me komorbiditete (kardiovaskulare, hematologjike dhe obezitas) dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal. Tek ato është konfirmuar influenza A(H1)pdm09.


MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 7.009 (I=381,6/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=5.106) numri i rasteve të regjistruara është rritur për 37,3%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=5.558) është regjistruar një rritje prej 26,1%.


Raste janë raportuar nga gjithsej 30 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (n=1.092) është regjistruar në QSHP Shkup ndërsa incidencë më e lartë kumulative (5.467,3/100.000) është regjistruar në Dibër.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas QShP/NjR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2023/2024



Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 3.894 (55,6%), ndërsa incidencë më e lartë (1.133,4/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=1.094).


Grafiku 3. Shpërndarja sipas grupmoshës dhe incidenca në 100.000 banorë, sezon 2023/2024



Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 2,8%
- nëntor – 268 raste ose 3,8%
- dhjetor – 829 raste ose 11,8%
- janar – 5.176 raste ose 81,6%

Grafiku 4. Shpërndarja sipas muajve, sezon 2023/2024



Deri më tani gjatë këtij sezoni janë regjistruar 8 raste të vdekjes si pasojë e gripit, nga Shtipi, Kumanova, Negotina, Gostivari, Demir Hisari dhe Shkupi, të grupmoshës nga 15-64 dhe mbi 65 vjet, të gjithë të hospitalizuar, me komorbiditete dhe të pavaksinuar kundër gripit sezonal. Tek të gjitha rastet është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e katërt, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 636 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuara janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë detektuar 95 raste pozitive, 78 Influenza A(H1)pdm09, 8 Influenza A(H3) dhe 8 Influenza A – e pasubtipizuar dhe 11 Influenza B.

Janë regjistruar edhe 9 raste pozitive me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar 29 raste me Virus Respirator Sincicial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së katërt janë raportuar gjithsej 69 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve - Shkup (n=26; 37,7%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=29; 42,0%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 219, me 8 raste në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 31,5% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 70,8%vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së katërt për analizë laboratorike kanë arritur 45 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, virusin sincicial respirator edhe për COVID-19. Në 45 mostrat e analizuara tek 16 është vërtetuar prani e virusit të gripit Influenza A(H1)pdm09, në 3 Influenza A(H3) dhe në 1 Influenza A – e pasubtipizuar. Në 3 mostra është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 4 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 706 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (n=241; 34,1%) janë raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve Shkup. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=352; 49,5%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 3.351, nga të cilët 31 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 21,1% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 40,0% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 8 raste të vdekjes, që i përkasin grupmoshës 30-64 vjet dhe mbi 65 vjet, me komorbiditete me Influenza A(H1)pdm09 ndërsa një me SARS-CoV-2.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 362 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në 57 mostra është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, në 3 Influenza A(H3), 1 Influenza A e pasubtipizuar dhe në 1 Influenza B e papërcaktuar dhe një 1 Influenza B/Victoria. Janë regjistruar 25 raste pozitive me COVID-19.

Nga mostrat SARI, 263 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 102 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e Influenza A(H1)pdm09 dhe SARS-CoV-2.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e katërt të vitit 2024, pranë laboratorit të virologjisë në ISHP kanë arritur 999 materiale, që janë testuar për prani të virusit të influencës dhe SARS-CoV-2.

Janë zbuluar 160 raste me Influenza:

- **Influenza A – 118 (98,3%)**


- **Influenza A – 157 (98,1%)**
 - Influenza A(H1)pdm09 – 135 (86,0%)
 - Influenza A(H3) – 13 (8,3%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar - 9 (5,7%)
- **Influenza B – 3 (1,9%)**
 - Influenza B/Victoria – 1 (33,3%)
 - Influenza B – e papërcaktuar – 2 (66,7%)

Janë regjistruar 34 raste pozitive me SARS-CoV-2, 133 me (RSV) dhe 10 me viruse të tjera respiratorë.

Nga rastet me Influenza dhe COVID-19, tek 6 raste është vërtetuar infekzion i dyfishtë (“flurona”).

Janë regjistruar 129 raste pozitive me (RSV) dhe 10 me viruse respiratore të tjera.

Grafiku 5. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes së rasteve pozitive me grip, RMV, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngashme me gripin, i cili është mbi kufirin favor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit tregojnë aktivitet të gjerë të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënavë, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përhapje të gjerë gjeografike intensitet të lartë të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnjerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shëtësë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij reporti janë vaknuar gjithsej 58.962 persona nga kategoritë e rezikuara të qytetarëve.

4.500 vaksina shëtësë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.572 persona.

Deri në javën e katërt në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 61.543 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Sumary) të publikuar në javën e tretë të vitit 2024 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infekzionet akute të frysëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 26 nga 33 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdon të rritet, aktiviteti i COVID-19 mbetet i lartë por me tendencë për rënien, ndërsa i RSV ka filluar të bjerë.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV në 2 javët e fundit kanë shënuar rënien.
- Zbulimet e vërtetuara të infekzionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (97%) - A(H1)pdm09 (73%) и A(H3) (27%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëqyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 22% krahasuar me 26% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar ishte 11% .
- SARS-CoV-2 është në 7% krahasuar me 9% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 4% (shtrirja: 0–22%).
- RSV ishte 13% krahasuar me 13% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 9% (shtrirja: 0-25%).

Nga vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet shumë të lartë, 8 për të lartë, 17 kanë raportuar intensitet mesatar, 10 të ulët dhe 5 kanë raportua intensitet bazë.

Nga vendet që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 30 kanë raportuar për shpërndarje të gjërë, 5 - rajonale, 3 - sporadike, 1 - lokale.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik**